



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 07 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3215_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47, Nenin 48, dhe Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Dispozitat e Nenit 27 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085), Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së), Parimet për përcaktimin të ngarkesave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes, Vendimin V_3212_2026 të datës 05 maj 2026 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH dhe Propozimin e OSSH-së, për aprovimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar në ZRRE nr. 430/26 më datë 06 maj 2026,

në seancën e mbajtur më 07 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- II. Struktura e Tarifave për SHSSH që zbatohet nga OSSH janë dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.84
10 kV	€/kWh	2.19
0.4 kV	€/kWh	3.37

- III. Vendimi do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga data 1 maj 2026 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.



ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) më datë 12 dhjetor 2025 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- ZRRE sipas dokumentit iniciues dhe njoftimit publik, ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve vjetore të të hyrave dhe tarifave për vitin relevant tarifor 2026, ka për qëllim që të siguroj që të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarit e rregulluar të jenë në përputhje dhe në pajtueshmëri me kostot reale dhe parashikimet për periudhën tarifore.
- ZRRE ka njoftuar se në pajtim me Rregullat e të Hyrave për të Licencuarit, parashikimet duhet azhurnuar për të marr parasysh dallimet nëpërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Pra, përshtatjet barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin “t” në kuadër të procesit relevant tarifor. Po ashtu ka theksuar se pas mbledhjes së të dhënave relevante nga të licencuarit, do të analizoj dhe vlerësoj aplikacionet e të licencuarve për të përcaktuar kostot reale që reflektohen në tarifatat përkatëse.
- ZRRE ka theksuar se, në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka mandat për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifave për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin me Shërbim Universal, duke siguruar që tarifatat të reflektojnë kostot reale dhe të arsyeshme të shërbimit.
- ZRRE, po ashtu përmes njoftimit ka theksuar se, do të publikojë aplikacionet sapo të vlerësohen si të kompletuara dhe siguron palët e interesit që vendimet përfundimtare do të marrin parasysh të dhënat relevante dhe komentet e tyre.
- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për të hyrat e lejuara maksimale, në kuadër të procesit të shqyrtimit të aplikimit dhe sqarimeve të mëtejshme, ZRRE nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar nga OSSH sh.a. dhënien e informacionit, përditësimin e të dhënave, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara në mënyrë që të kemi transparencë për marrjen e një vendimi të drejtë e kosto reflektues të tarifave.
- ZRRE më datë 26 janar 2026 ka pranuar aplikacionin nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), ka pranuar aplikacionin për azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, duke paraqitur të dhënat e realizuara për vitin 2025 dhe kërkesat për vitin 2026.
- OSSH (KEDS sh.a.) në aplikacionin e saj për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026, ka paraqitur arsyetimet lidhur me ndryshimet operative dhe kapitale, përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e lidhura me hapjen e tregut të energjisë elektrike, kostot operative në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, kostot e humbjeve në shpërndarje, kostot e zhvlerësimit dhe kthimit në investime, si dhe faktorët korrigjues të të hyrave.
- ZRRE, gjatë vlerësimit fillestar dhe shqyrtimit të aplikacionit të OSSH-së, ka zhvilluar proces të detajuar të verifikimit dhe validimit të të dhënave të paraqitura nga OSSH, përfshirë sqarimet shpesh, përditësimet dhe korrigjimet e nevojshme, me qëllim që të sigurojë që të dhënat e përdorura në llogaritjet tarifore të jenë të plota, të sakta dhe të konsoliduara. Në kuadër të këtij procesi, ZRRE ka analizuar treguesit teknik, ekonomik dhe financiar të OSSH-së, si dhe Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në sektorin elektroenergetik.



- ZRRE më datë 10 prill 2026 ka publikuar Raportin Konsultativ për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2026, me qëllim të garantimit të transparencës procedurale dhe përfshirjes së palëve të interesit në procesin vendimmarrës. Përmes këtij raporti, ZRRE ka paraqitur vlerësimet fillestare lidhur me komponentët e HLM-së, dhe ka ftuar palët e interesit që të paraqesin komentet dhe kundërshtimet e tyre të arsyetuara.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka sqaruar se përshtatjet e rregullta janë mekanizma kyç rregullator që mundësojnë përditësimin e të hyrave për të reflektuar ndryshimet ndërmjet vlerave të parashikuara dhe atyre reale të kostove që janë jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar, përfshirë inflacionin, kostot e blerjes së energjisë, vëllimet e energjisë së shpërndarë dhe faktorë të tjerë relevant.
- ZRRE përmes Raportit Konsultativ ka theksuar se, në kuadër të procesit të përshtatjeve të rregullta, shqyrtohen vetëm komponentët e kostos që ndryshojnë nga viti në vit, ndërsa parametrat bazë rregullator të përcaktuar në kuadër të Shqyrtimit Periodik Tarifor 2023–2027 mbeten në fuqi gjatë gjithë periudhës rregullative, përfshirë parametrat e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB), normën e kthimit të lejuar dhe objektivat e efikasitetit.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ për OSSH, ka trajtuar përditësimin e lejimeve të kostove të indeksuara për vitin relevant tarifor 2026, duke përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX), kostot e zhvlerësimit dhe kthimin e lejuar në kapital. ZRRE ka vlerësuar se këto kosto duhet të përditësohen në përputhje me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH dhe parametrat rregullatorë të përcaktuar në kuadër të Shqyrtimit Periodik Tarifor 2023–2027.
- ZRRE ka sqaruar se kostot operative dhe kapitale të lejuara për OSSH-në, indeksohen me normën e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP), të publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës, ndërsa norma e inflacionit prej 2.13% është reflektuar në komponentët relevantë të kostove të lejuara për vitin 2026 me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar të operatorit të rregulluar dhe reflektimit të kostove reale në tarifatat përkatëse.
- ZRRE, gjatë shqyrtimit të aplikacionit të OSSH-së, ZRRE ka analizuar propozimet e paraqitura nga OSSH lidhur me kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot shtesë operative, investimet kapitale dhe ndikimin e tyre në zhvlerësim dhe kthimin e lejuar në kapital. Pas analizimit të dokumentacionit mbështetës dhe të dhënave të dorëzuara nga OSSH, ZRRE ka vlerësuar se vetëm kostot e arsyeshme, të justifikuara dhe të verifikuara duhet të reflektohen në të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka analizuar propozimet e paraqitura nga OSSH lidhur me kostot operative dhe të mirëmbajtjes, përfshirë kërkesat për rritjen e OPEX-it, kostot shtesë operative të ndërlidhura me hapjen e tregut të energjisë elektrike, kostot operative në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, si dhe kostot e personelit dhe kostot tjera operative të paraqitura nga OSSH si pjesë e aplikacionit për vitin relevant tarifor 2026. Në këtë drejtim, OSSH ka kërkuar njohjen e kostove shtesë operative në shumën prej 7 milion €, duke arsyetuar se këto kosto ndërlidhen me nevojat operative të krijuara nga procesi i liberalizimit të tregut, operimi në komunat veriore dhe nevojat shtesë për mirëmbajtje dhe menaxhim të rrjetit të shpërndarjes.
- ZRRE, pas analizimit të dokumentacionit mbështetës, arsyetimeve të paraqitura nga OSSH dhe vlerësimit të ndikimit të këtyre kostove në operimin e sistemit të shpërndarjes, ka vlerësuar se vetëm kostot e arsyeshme, të justifikuara dhe të verifikuara duhet të reflektohen në të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026. ZRRE ka propozuar që kostot operative dhe të mirëmbajtjes për OSSH të aprovohen në nivelin prej 32.752 milion €, ndërsa kostot e zhvlerësimit



dhe kthimi i lejuar në kapital të reflektohen në përputhje me parametrat e përcaktuar në kuadër të periudhës rregullative 2023–2027.

- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka trajtuar përshtatjen e parashikimit të humbjeve të lejuara për vitin relevant tarifor 2026, duke analizuar vëllimin e humbjeve, çmimin e energjisë për mbulimin e humbjeve dhe parashikimin e kostove të humbjeve në sistemin e shpërndarjes. ZRRE ka marrë në konsideratë Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike, nivelin e humbjeve të lejuara të përcaktuara në kuadër të periudhës rregullative 2023–2027 dhe zhvillimet aktuale të tregut të energjisë elektrike.
- ZRRE ka vlerësuar se niveli i humbjeve të lejuara për OSSH për vitin 2026 duhet të reflektojë objektivat rregullatore për reduktimin gradual të humbjeve në sistemin e shpërndarjes. ZRRE ka propozuar që humbjet e lejuara në shpërndarje për vitin 2026 të jenë në nivelin prej 842.46 GWh, që përfaqësojnë 12.79% të energjisë që hyn në rrjetin e shpërndarjes, krahasuar me 13.85% të propozuara nga OSSH. Gjithashtu, ZRRE ka vlerësuar se për katër komunat veriore të Republikës së Kosovës niveli i humbjeve duhet të përcaktohet në 18.5%, duke marrë parasysh specifikat operative dhe zhvillimet në atë pjesë të sistemit të shpërndarjes.
- Lidhur me çmimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, ZRRE ka analizuar të dhënat historike të tregut, trendet e bursave rajonale të energjisë dhe projeksionet për vitin 2026, duke vlerësuar se çmimi mesatar i importit për vitin 2026 duhet të përcaktohet në nivelin prej 129.76 €/MWh. Si rezultat i rishikimit të çmimeve dhe vëllimeve të energjisë në përputhje me Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike, ZRRE ka propozuar që kostoja e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të OSSH-së për vitin 2026 të aprovohet në shumën prej 80.752 milion €, krahasuar me 107.410 milion € të propozuara nga OSSH.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka trajtuar edhe komponentin e të ardhurave të parregulluara, duke analizuar të hyrat që OSSH realizon nga aktivitetet jo-tarifore dhe ndikimin e tyre në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2026. ZRRE ka vlerësuar se të ardhurat e parregulluara duhet të zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale në përputhje me metodologjinë rregullatore në fuqi, me qëllim të shmangies së rikuperimit të dyfishtë të kostove përmes tarifave të rregulluara.
- ZRRE, gjatë shqyrtimit të aplikacionit të OSSH-së, ka analizuar të dhënat e raportuara lidhur me të hyrat e realizuara nga kyçjet e reja, shërbimet tjera ndaj konsumatorëve, penalitetet, kompensimet dhe aktivitetet tjera jo-tarifore të OSSH-së. Pas analizimit të të dhënave historike, realizimeve për vitin 2025 dhe projeksioneve për vitin 2026, ZRRE ka vlerësuar se të ardhurat e parregulluara duhet të reflektohen në përputhje me realizimet reale dhe pritjet e arsyeshme për periudhën relevante tarifore.
- ZRRE përmes Raportin Konsultativ ka trajtuar edhe faktorin e korigjimit të të hyrave (KREV) për vitin e realizuar 2025, duke analizuar dallimet ndërmjet të hyrave të lejuara dhe të hyrave reale të realizuara nga OSSH, si dhe ndikimin e devijimeve në kostot e humbjeve, kostot operative dhe komponentët tjerë relevantë tarifor. OSSH ka propozuar faktor korigjues në shumën prej 41.857 milion €, ndërsa ZRRE, pas analizimit të kostove të pranuar dhe aplikimit të parimeve të arsyeshmërisë dhe efikasitetit të kostove, ka propozuar faktor korigjues në shumën prej 30.108 milion €.
- ZRRE ka vlerësuar se dallimet kryesore ndërmjet propozimit të OSSH-së, dhe vlerësimit të ZRRE-së, lidhen me kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve, kostot operative dhe faktorin korigjues të të hyrave, duke konsideruar se vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikuara duhet të reflektohen në tarifat e rregulluara. ZRRE ka konstatuar se komponenti “Përshtatjet e



tjera” në shumën prej 0.38 milionë €, i propozuar nga OSSH si pjesë e kostove operative, nuk duhet të merret në konsideratë për qëllime tarifore, pasi nuk është vlerësuar si kosto e arsyeshme dhe e justifikuar.

- ZRR, pas analizimit të aplikacionit të OSSH-së, dokumentacionit mbështetës, Bilancit të përditësuar të Energjisë Elektrike dhe të gjithë komponentëve relevantë tariforë të trajtuar në Raportin Konsultativ, ZRRE ka propozuar që të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2026 të aprovohen në shumën prej 184.746 milion €, krahasuar me 235.384 milion € të propozuara nga OSSH. ZRRE ka vlerësuar se ky nivel i të hyrave siguron mbulimin e kostove të arsyeshme dhe të nevojshme për operimin e sistemit të shpërndarjes, duke mbrojtur njëkohësisht interesin e konsumatorëve dhe duke reflektuar parimet e rregullimit ekonomik dhe tarifimit kosto-reflektues.
- ZRRE gjatë procesit të konsultimit publik për Raportin Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2026, ka pranuar komente dhe rekomandime nga Organizata e Shoqërisë Civile INDEP, si dhe nga të licencuarit KEDS, KESCO, KOSTT, KEK dhe Elektroserver. Komentet e paraqitura kanë trajtuar çështje që ndërlidhen me kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e personelit, kostot e hapjes së tregut të energjisë elektrike, kostot operative në komunat veriore të Republikës së Kosovës, nivelin e humbjeve të lejuara, çmimin e energjisë për mbulimin e humbjeve, faktorët korrigjues të të hyrave dhe komponentët tjerë relevantë tariforë të OSSH-së. ZRRE ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe dëshmitë e paraqitura gjatë procesit konsultativ dhe ka vlerësuar secilin pretendim në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial, metodologjitë tarifore dhe parimet e rregullimit ekonomik.
- ZRRE, pas shqyrtimit të komenteve të pranuar dhe analizimit të të dhënave të përditësuara të dorëzuara nga OSSH dhe palët tjera të interesit, ka përgatitur Raportin Final për Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH për vitin tarifor 2026. Në këtë raport janë reflektuar përditësimet e nevojshme të bazuara në realizimet reale për muajt e parë të vitit 2026, përditësimet e Bilancit të Energjisë Elektrike dhe vlerësimet përfundimtare të ZRRE-së lidhur me komponentët relevantë të HLM-së për OSSH. ZRRE ka theksuar se Raporti Final është përgatitur në funksion të garantimit të një procesi transparent, objektiv dhe kosto-reflektues të përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar.
- ZRRE në Raportin Final për OSSH, ZRRE ka vlerësuar se ndryshimet ndërmjet Raportit Konsultativ dhe vlerësimeve përfundimtare lidhen kryesisht me përditësimin e kostove të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve, bazuar në kostot reale të realizuara për muajin mars 2026 dhe përditësimin e çmimeve të parashikuara të importit për pjesën e mbetur të vitit 2026. ZRRE ka zëvendësuar kostot fillestare të parashikuara për muajin mars 2026 me kostot reale të realizuara dhe ka rritur çmimin e parashikuar të importit për muajt e mbetur të vitit 2026 për 2.65 €/MWh.
- ZRRE në Raportin Final lidhur me kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX ka shqyrtuar komentet dhe arsyetimet e paraqitura nga OSSH lidhur me kostot e personelit, kostot operative shtesë të ndërlidhura me hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe kostot operative në komunat veriore të Republikës së Kosovës. Pas analizimit të dokumentacionit dhe komenteve të pranuar, ZRRE ka vlerësuar se niveli i kostove operative dhe të mirëmbajtjes i propozuar në Raportin Konsultativ duhet të mbetet i pandryshuar në shumën prej 32.752 milion €, duke konsideruar se vetëm kostot reale, të arsyeshme dhe të justifikuar duhet të reflektohen në tarifat e rregulluara.
- ZRRE ka analizuar komentet e OSSH-së dhe të palëve të tjera të interesit lidhur me vëllimin e humbjeve, çmimin e energjisë elektrike dhe zhvillimet në tregun rajonal të energjisë. Në këtë drejtim, ZRRE ka konstatuar se përditësimi i kostove reale për muajin mars 2026 dhe rritja e çmimit të parashikuar të importit për pjesën e mbetur të vitit 2026 kanë ndikuar në rritjen e



kostos së lejuar për humbjet në shpërndarje nga 80.752 milion € në Raportin Konsultativ në 81.602 milion € në Raportin Final.

- ZRRE ka shqyrtuar realizimet financiare të OSSH-së për vitin 2025 dhe komentet e paraqitura gjatë procesit konsultativ, duke vlerësuar ndikimin e devijimeve ndërmjet të hyrave të lejuara dhe të hyrave reale të realizuara. Si rezultat i përditësimeve të bëra në komponentët relevantë tarifor, ZRRE në Raportin Final ka propozuar që faktori korigjues i të hyrave për OSSH për vitin 2026 të aprovohet në shumën prej 30.473 milion €, krahasuar me 30.108 milion € të propozuara në Raportin Konsultativ.
- ZRRE, gjatë shqyrtimit të komenteve të INDEP lidhur me kostot operative, nivelin e humbjeve të lejuara dhe kostot e energjisë për mbulimin e humbjeve, ka vlerësuar se metodologjia e aplikuar për përcaktimin e kostove të lejuara është bazuar në të dhënat më të fundit reale të disponueshme, Bilancin e përditësuar të Energjisë Elektrike dhe zhvillimet aktuale të tregut të energjisë elektrike. Gjithashtu, ZRRE ka theksuar se qasja e përdorur synon të shmangë mbivlerësimin e kostove dhe të mbrojë konsumatorët nga bartja e kostove të panevojshme në tarifatat e rregulluara.
- ZRRE pas shqyrtimit të aplikacionit të OSSH-së, Raportit Konsultativ, komenteve të palëve të interesit dhe vlerësimeve të përfshira në Raportin Final për OSSH, ka vlerësuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH për vitin relevant tarifor 2026 duhet të aprovohen në shumën prej 185,960,935 €, duke konsideruar se kjo vlerë siguron mbulimin e kostove të arsyeshme dhe të nevojshme për operimin e sigurt, stabil dhe efikas të sistemit të shpërndarjes, në pajtim me legjislacionin sektorial dhe metodologjitë rregullatore në fuqi.
- Andaj të Hyrat Maksimale të Lejuara që do të mblidhen nga OSSH, për vitin 2026 do të jenë në shumë e 185,960,935 €, ashtu siç është vendosur me Vendimin V_3112_2026 të datës 05 maj 2026.
- OSSH bazuar në pikën III. të dispozitivit të Vendimit V V_3112_2026 të datës 05 maj 2026 është obliguar t'i përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes për vitin 2025.
- ZRRE më datë 06 maj 2026 ka pranuar nga OSSH ka pranuar propozimin për Tarifatat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes.
- ZRRE ka vlerësuar tarifatat e propozuara nga OSSH dhe ka konstatuar se tarifatat janë kalkuluar në pajtueshmëri me Metodologjinë për Përcaktimin e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes. Propozimi i OSSH për tarifatat e OSSH është i bazuar në vendimin e ZRRE-së, për të Hyrat e Lejuara Maksimale V_3112_2026 të datës 05 maj 2026.
- Vlen të theksohet se, KEDS në aplikacionin për tarifatat e OSSH-së, ka propozuar mbajtjen e tarifave aktuale, duke u bazuar në një nivel të shitjeve prej **5.581 GWh**. Ndërkohë, ZRRE, pas shqyrtimit dhe verifikimit të të dhënave, ka marrë në konsideratë Bilancin e Energjisë Elektrike të aprovuar, me një nivel të shitjeve prej **5.745 GWh**, të cilat i ka reflektuar në tarifatat të OSSH-së.
- ZRRE ka vlerësuar propozimin për Tarifatat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarje dhe ka ardhur në përfundim se tarifatat i reflektojnë drejt kostot e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve përkatëse.



- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për Tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarje, duke u bazuar në vendimin V_3112_2026 të datës 05 maj 2026 për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSh dhe Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, ka vlerësuar se janë kalkuluar tarifat e OSSH-së, për kostot e shërbimit për vitin relevant tarifar 2026, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Ganj Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KEDS,
 - KESCO,
 - KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.